



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 29.07.2013

Nr. 0203-989

PËR: Avni Kastrati, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Rrustem Musa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES TË KOMUNËS
SË MITROVICËS, Nr. 02/06 - 14916/2 Pranuar me datë, 24.07.2013**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-04, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Rregullores Nr. 02/06 -14916/2 të miratuar me datë 27.06.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Rregullore Nr. 02/06 - 14916/2, për mbrojtjen e të miturve nga dukurit që dëmtonin shëndetin dhe zhvillimin e tyre Nr. 16/2013.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 29.07.2013
br. 0203-989

Za: Avni Kastrati, Gradonačelnik opštine Mitrovica
Rrustem Musa, Predsedavajući Skupštine opštine Mitrovica

Predmet: Potvrda zakonitosti uredbe opštine Mitrovica
br. 02/06-14916/5 Primitjeno dana , 24.07.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja uredbe br. 02/06-14916/2 odobreno dana 27.06.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Uredba br. 02/06-14916/2, o zaštiti maloletnika od negativnih pojava koje ugrožavaju njihovo zdravlje i razvoj.br. 16/2013.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.

24.07.2013 Prilim 15



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 02/06 - 14916/2 dt. 27.06.2013
Mitrovicë

	REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA	
D.T. Nr. Prot./Br Prot.	02/06-14916/2	
Art. i Kusht.		
Çelori/Çeloret	27.06.2013	
Qendër	Mitrovicë - Mitrovica	

**RREGULLORJA Nr. 16/2013
PËR
MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË
DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE**

	HYRËSE-ULAZNA-INCOMING REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA DEVERIA E KOSOVËS-VLADAT/KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date	24.07.2013		
Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-11-	0213-989		

Qershor, 2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

KUVENDI I KOMUNËS

Nr. 02/06 – 14916/2 dt. 27.06.2013

Mitrovicë

Në bazë nenit 12 paragrafi 2 alinea c) dhe nenit 17 alinea s) të Ligjit nr. 03/L - 040 Për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), nenit 39 të Ligjit nr. 04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/2011) të datës 16.09.2011; nenit 23 paragrafi 2 alinea c) të Statutit të Komunës nr. 02/06-7444/3 të dt. 23.09.2011; Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në mbledhjen e mbajtur më dt. 27.06.2013 nxjerr:

RREGULLOREN Nr. 16/2013

PËR

MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve. Kushtet në të cilat personat fizik, organizatat tregtare dhe shërbyese, mund t'u ofrojnë në shitje ose shërbime tjera që janë të ndaluara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, e që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përkufizimet

Neni 2

1. Të mitur - konsiderohen personat prej moshës 14 deri në 18 vjeç:
 - 1.1.1 Të miturit prej moshës 14 deri 16 vjeç, konsiderohen të mitur të rinj,
 - 1.1.2 Të miturit prej moshës 16 deri 18 vjeç janë të mitur të rritur.
2. Dispozitat e kësaj rregullore vlejné edhe për personat nën moshën 14 vjeçare.
3. Dukuri negative - konsiderohen: konsumimi i alkoolit, duhanit, narkotikëve të ndryshëm, shfaqjet degjeneruese, frekuentimi i të rinjve në lokalet e ndryshme në orët e vona etj.
4. Vende publike - konsiderohen hapësirat, lokalet e ndryshme hoteliere shërbyese dhe tregtare, kafiteritë, internet kafetë, institucionet kulturore, objektet edukativo-arsimore, kinematë dhe lokalet e natyrës së tillë.

Neni 3

1. Ndalohet rreptësishtë shitja dhe përdorimi i të gjithave pijeve alkoolike dhe duhanit brenda objekteve edukativo - arsimore.

2. Të gjitha subjektet nga neni 4 të kësaj rregulloreje, janë të obliguara që në hyrje apo në brendi të vendosin tabelën (shenjën) për ndalimin e shitjes dhe shërbimit të pijeve alkoolike dhe duhanit për të mitur, konform dispozitave të kësaj rregulloreje dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
3. Ndalohet shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike për të miturit nga subjektet afariste.
4. Ndalohet shitja dhe shërbimi me duhan apo çdo lloj tjetër i duhanit të miturve nga subjektet tregtare që merren me shitjen dhe shërbimin e tyre.
5. Të miturit e rritur mund të shesin pije alkoolike dhe duhan, vetëm në prani ose me leje dhe pëlqim të prindërve apo kujdestarit ligjor, në objektet që posedojnë leje përkatëse.
6. U ndalohet rreptësisht personave nën moshën 16 vjeçare të shesin pije alkoolike dhe duhan.

Obligimet e subjekteve biznesore dhe të miturit

Neni 4

1. Të miturit nën moshën 16 vjeçare, mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli vetëm në prani të prindit ose kujdestarit ligjor.
2. Të miturit e rritur mund të qëndrojnë deri në ora 20:00, ndërsa pas orës 20:00 vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Në lokalet, si: loto, bingo, prognoza sportive apo lojëra fati, ndalohet hyrja e të miturve.
4. Organizatorët e shfaqjeve të ndryshme, programeve dhe manifestimeve publike dhe kulturore për të rinjtë në lokalet e mbyllura janë përgjegjës në rast se në ato lokale lejojnë përdorimin e pijeve alkoolike apo duhanit nga të miturit në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
5. Të miturve u ndalohet grumbullimi dhe shitja e mbeturinave të metalta.

Kinematë, internet kafetë dhe shtypi

Neni 5

1. Kinematë apo subjektet tjera që merren me shfaqje publike të filmave, janë të detyruara që për fëmijët deri në moshën 14 vjeçare të shfaqin ato deri në ora 18:00, prej moshës 14 deri në 16 vjeçare deri në ora 19:00, ndërsa për të miturit prej 16 deri në 18 vjeç deri në ora 20:00.
2. Pas orës 20:00 shfaqjet e tilla, të miturit mund t'i përcjellin vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Kinematë apo subjektet tjera, janë të obliguara që me rastin e shfaqjes së filmave, përmbajtja e të cilave ndikon negativisht në formimin e të miturve në aspektin edukativ, arsimor dhe kulturor, të njoftojnë me rastin e reklamimit të filmit si dhe në hyrje të objektit ta kenë shenjën për ndalimin e hyrjes dhe njëkohësisht janë të obliguara që mos të lejojnë hyrjen e tyre.
4. Internet kafetë janë të obliguara që t'i ndalojnë hapjen e ueb-faqeve të cilat ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit dhe edukimit të të miturve.
5. Botuesit dhe shitësit e revistave të ndryshme, përmbajtja e të cilave është degjeneruese dhe të cilat ndikojnë negativisht në edukimin arsimorë, shëndetësorë dhe kulturorë të të miturve nuk mund t'i shesin të miturve deri në moshën 18 vjeçare.
6. Video klubet apo subjektet që merren me shitjen e videokasetave, DVD-ve, CD-ve, përmbajtja e të cilave është degjeneruese, janë të obliguara që të mos u shesin dhe të mos u lejojnë të miturve përdorimin e tyre.

Neni 6

Inspektorët komunal dhe policia do të kujdesen dhe do të mbikëqyrin zbatimin e kësaj rregulloreje nga subjektet përkatëse dhe do të ndërmarrin masat dhe veprimet përkatëse sanksionuese.

Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat

Neni 7

1. Personi juridik-subjekti afarist, nëse në lokalim e tij shet ose shërben pije alkoolike në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 paragrafi 1, 3, 4, 5 dhe 6 i kësaj rregulloreje, për kundërvajtjen e kryer, do të dënohet me gjobë prej 500.00 – 2000.00 €, ndërsa personi fizik që shkel dispozitat e nenit 3 paragrafi 1, 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, dënohet me gjobë mandatore prej 200.00 €.
2. Me gjobë mandatore në shumë prej 50.00 € do të dënohen:
 - 2.1 Nëse të miturit i lejohet qëndrimi në restaurant apo kafiteri etj., në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 paragrafit 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje.
 - 2.2 Nëse subjektet nga neni 4 paragrafi 4 veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
 - 2.3 Organizuesit e shfaqjeve, manifestimeve etj, veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
3. Me gjobë mandatore në shumë prej 50.00 € do të dënohen personat përgjegjës të subjekteve nga neni 4, nëse nuk respektohen dispozitat e paragrafit 2 pika 1 të këtij neni dhe veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 8

Nëse personi juridik-subjekti afarist nuk bën pagesën e gjobave të shqiptuara në pajtim me dispozitat e nenit 7.2 dhe 7.3 të kësaj rregulloreje, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së shqiptimit të gjobës, do të iniciohet procedura për ekzekutim në Gjykatën kompetente.

Neni 9

Të gjitha mjetet e arkëtuara nga shqiptimi i masave ndëshkuese manadatore do të derdhen në Buxhetin Komunës.

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 10

Për implementimin (zbatimin) e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni 11

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 12

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Komunës.

Mitrovicë

3

